



SIXTH ENVIRONMENTAL AND SOCIAL BULLETIN
BULETINI I GJASHTË MJEDISOR DHE SOCIAL



Tirana International Airport
Nënë Tereza

Table of contents

Tabela e përmbajtjes

Message from the CEO
Mesazhi nga CEO

3

Environmental and Quality Management
Menaxhimi i Cilësisë dhe Mjedisit

4

Health and Safety
Shëndeti dhe Siguria

16

Customers and Social aspects
Klientët dhe Aspekte sociale

20

Main events
Ngjarjet kryesore

26

Facts and Figures
Fakte dhe Shifra

30



Andrea Gebbeken
CEO

Dear passenger,

The rapid growth in air travel world-wide has elevated the level of interest in and concern with the significance and complexity of environmental issues. New standards applicable to certain operations need to be developed and, in line with this, raising awareness is a key factor in order to address one of the most significant issue: changes in staff behaviour.

With regard to these matters, energy management at Tirana International Airport (TIA) has become an important issue in the company's policies. It focuses on three primary areas: 1) energy efficiency (reducing electricity and fuel consumption by both the company and its customers), 2) infrastructure (securing and maintaining secure and reliable utility infrastructure), and 3) ensuring greater energy security and reliability and competitive procurement of energy commodities.

Aiming towards optimization of energy efficiency and reduction of energy costs, TIA, in cooperation with its shareholder HOCHTIEF Airport, has started an Energy Saving Project and is developing sustainable energy-saving actions. The project began in April 2011 in order to assess future needs and requirements for modernizing the existing infrastructure and installations. The Company has taken several measures so far, including optimization of the air handling unit in the passenger terminal and administration building, energy-efficient illumination in the terminal and improvements in ground service equipment. Furthermore, the airport is in the process of further analyzing and defining the Airport's carbon footprint.

TIA is proud to care for the environment; we have started to save energy in order to start improving our planet's environment and protecting it for future generations. So please join our initiative, save energy today: your children will thank you tomorrow!

Sincere regards, Andrea Gebbeken.

I dashur pasagjer,

Rritja e shpejtë në trafikun ajror në mbarë botën ka ndikuar mbi nivelin e interesit apo shqetësimin dhe rëndësinë e kompleksitetin e çështjeve mjedisore. Nevojitet të zhvillohen standarde të reja për t'u aplikuar në disa aktivitete të caktuara të aeroportit dhe në përputhje me këtë, rritja e ndërgjegjësimit është një faktor kyç në mënyrë që të përmbushet një nga çështjet më të rëndësishme: Ndryshimi në sjelljen e stafit.

Në lidhje me këto çështje, menaxhimi i energjisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA) është kthyer në një çështje me rëndësi në politikat e kompanisë. Ai fokusohet në tre fusha kryesore: 1) efikasitetin e energjisë (Reduktimi i konsumit të energjisë elektrike dhe karburantit si nga vetë kompania dhe konsumatorët), 2) Infrastruktura (Sigurimi dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimeve të sigurt dhe të besueshme), dhe 3) Garanci e lartë mbi sigurinë dhe besueshmërinë për energjinë dhe prokurimin konkurrenës të energjisë.

Duke synuar optimizimin e efikasitetit të energjisë dhe reduktimin e kostos së energjisë, TIA në bashkëpunim me aksionerin HOCHTIEF AirPort, ka filluar një Projekt të Kursimit të Energjisë, duke zhvilluar veprime të kursimit të energjisë së qëndrueshme. Projekti filloi në prill 2011 si nevojë për të përmbushur kërkesat e së ardhmes, kërkesat në vazhdimësi si dhe për të modernizuar infrastrukturën dhe instalimet ekzistuese. Kompania ka marrë disa masa deri më tani, duke përfshirë: optimizim të njësisë së trajtimit të ajrit në terminalin e pasagjerëve dhe ndërtesën e administratës, ndriçim me energji eficientë në terminalin e pasagjerëve, përmirësim në pajisjen e shërbimit në tokë (GSE) dhe ndërmarrjen e analizave të mëtejshme për të përcaktuar gjurmën e karbonit të aeroportit.

TIA është krenare për kujdesin e treguar ndaj mjedisit, ne kemi filluar të kursejmë energji në mënyrë që të kontribuojmë në përmirësimin e mjedisit të planetit tonë, duke e mbrojtur atë për brezat e ardhshëm. Prandaj të ftojme të bashkohesh me iniciativën tonë, kurse energji sot: fëmijët do të të falenderojnë nesër!

Me respekt, Andrea Gebbeken.

Environmental and Quality Management

Menaxhimi i Cilësisë dhe Mjedisit



The environmental management system of Tirana International Airport (TIA), established in accordance with ISO 14001, continues to be implemented in a way that guarantees a sustainable development of the Airport. The commitment of the company's top management to comply with the applicable legislation and standards and continuously improve TIA's environmental, health and safety performance is reflected in its policies of quality and of environment, health and safety.

Within the framework of maintaining legal compliance, enhancing best practices and experiences, responding to new challenges, increasing TIA's reputation and promoting similar initiatives in the broader region of the Airport, TIA has set very ambitious targets. Issues of sustainable resource use, energy management, permanent noise monitoring, etc., are part of TIA's new initiatives. The company is aware that meeting and surpassing such commitments means involvement of all parties and reaching an understanding of their roles and responsibilities regarding environmental and quality management back to back with provision of the necessary resources for effective environmental and quality management system implementation.

Integrated Environmental and Quality Management System

The main objectives of TIA's Environmental and Quality Management System (EQMS) are to integrate environmental protection and quality management in all stages of Airport operations and, in addition, to extend environmental awareness and responsibility and involvement of all employees and third parties.

The proof of effectiveness of the EQMS is obtained through on-going performance monitoring and an auditing process that identifies compliance with relevant regulations and standards. TIA has ensured that the least possible negative impact is imposed on environment and health, either inside or outside the Airport area. This has been achieved by taking essential measures to prevent and mitigate negative impacts, thus meeting TIA's commitment to ensure environmental, health and safety standards in all areas.

Sistemi

i menaxhimit të mjedisit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), i krijuar në përputhje me ISO 14001, vazhdon të zbatohet në mënyrë të tillë që garanton zhvillim të qëndrueshëm të Aeroportit. Përkushtimi i stafit drejtues të kompanisë për të respektuar legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet si dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme performancën mjedisore, të shëndetit dhe të sigurisë, është reflektuar në politikën e cilësisë si dhe të mjedisit, shëndetit dhe sigurisë.

Brenda kuadrit të sigurimit të përputhshmërisë ligjore, nxitjes së praktikave dhe eksperiencave më të mira, duke iu përgjigjur sfidave të reja, duke rritur reputacionin e TIA-s dhe nxitur iniciativa të ngjashme në një kontekst më të gjerë se zona e Aeroportit, TIA ka vendosur objektiva shumë ambiciozë. Çështjet e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve, menaxhimi i energjisë, monitorimi i zhurmave në mënyrë të vazhdueshme, etj. janë pjesë e iniciativave të reja të TIA-s. Kompania është e ndërgjegjshme që përbushja dhe tejkalimi i këtyre premtimeve, nënkupton përfshirjen e të gjitha palëve dhe arritjen e kuptimit të roleve dhe përgjegjësisë të tyre, e lidhur ngushtë kjo me sigurimin e burimeve të nevojshme për një zbatim efektiv të sistemit të menaxhimit të mjedisit dhe të cilësisë.

Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mjedisit dhe Cilësisë

Objektivat kryesorë të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë kanë si qëllim të integrojnë mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e cilësisë në të gjitha stadet e operimeve të Aeroportit dhe në të njëjtën kohë të rrisin ndërgjegjësimin mjedisor dhe përgjegjshmërinë e përfshirjen e të gjithë punonjësve dhe palëve të treta.

Kontrolli i efektshmërisë së Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të performancës dhe një procesi auditimi që identifikon përputhshmërinë me rregullat dhe standardet e duhura. TIA ka siguruar që të mos ketë asnjë ndikim negativ në mjedis dhe shëndet, si brenda edhe jashtë zonës së Aeroportit. Kjo gjë është arritur duke marrë masa të rëndësishme për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative, duke përbushur angazhimin e tij në sigurimin e standardeve mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë në të gjitha fushat.

Implementation of the Environmental, Health & Safety and Social Action Plan

TIA has implemented an Environmental, Health & Safety and Social Action Plan (EHSAP). In it environmental objectives and targets are set and checked carefully by identifying priority areas, programmes and respective specific actions and measures to be taken, including time schedules and responsible persons, departments and contractors for all management issues. Last year, one of the main challenges was TIA's optimization of energy efficiency, aiming at sustainable use of resources and energy saving.

Legal Compliance

TIA assures that the legal obligations, conditions and requirements of construction and operation, environmental and health & safety permits and consents are followed and performed by TIA and third parties.

Environmental Monitoring and Management

In compliance with its environmental permits, procedures and environmental & health legislation, TIA monitors noise levels, air quality, wastewater parameters and potable water quality in the Airport. According to TIA's Monitoring Programme, current performance against defined environmental objectives and targets is measured and monitored. Evaluation of compliance with applicable regulations and standards is continuously controlled.





Zbatimi i Planit të Veprimit të Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë dhe atij Social

Objektivat dhe synimet e Planit të Veprimit të Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë dhe atij Social të TIA-s janë përcaktuar dhe kontrolluar me kujdes nëpërmjet identifikimit të fushave prioritare, programeve dhe masave specifike që duhet të merren, afatet kohore dhe personat përgjegjës, departamentet, kontraktorët, për të gjitha çështjet e menaxhimit. Vitin e kaluar, një nga sfidat kryesore ishte optimizimi i efikasitetit energjetic në TIA, që synon përdorimin e qendrueshëm të burimeve dhe kursimin e energjisë.

Përputhshmëria Ligjore

TIA siguron që detyrimet, kushtet dhe kërkesat ligjore të lejeve të ndërtimit, operimit, mjedisit shëndetit dhe sigurisë si dhe aprovimet janë zbatuar dhe realizuar nga TIA dhe palët e treta.

Monitorimi dhe Menaxhimi i Mjedisit

Në përputhje me lejet mjedisore të TIA-s, procedurat dhe legjislacionit mjedisor dhe të shëndetit, TIA monitoron nivelet e zhurmave, cilësinë e ajrit dhe ujërat e ndotura dhe ujin e pijshëm në Aeroport dhe pranë tij. Sipas Programit të Monitorimit të TIA-s, performanca e tanishme kundrejt objektivave dhe synimeve mjedisore të përcaktuara matet dhe monitorohet. Vlerësimi i përputhshmërisë me rregulloret dhe standardet e aplikueshme kontrollohet vazhdimisht.



Air Quality Monitoring


TIA carries out continuous monitoring of air quality during both peak and non-peak seasons. The main objective of air quality monitoring is to obtain information on the concentration and changes in the main parameters that impact the environment and health, including levels of nitrogen dioxide (NO₂), ozone (O₃), carbon monoxide (CO), sulphur dioxide (SO₂) and particulate matter (PM₁₀).

Activities at or near the Airport involve many vehicles, typically those used for ground transportation, and other sources of gases and particulate matter that affect air quality. Thus, numerous areas of the Airport are continuously monitored for emissions. The results of the monitoring for 2011 are reported below graphically for each measured air parameter that impacts air quality.


The levels of emissions obtained from the monitoring are within the acceptable limits of both Albania (stated in Decision of the Council of Ministers—DCM—No. 803 dated 4 December 2003: On the norms of air quality) and the EU.

Part of the air quality monitoring programme involves measurement of the main micro-climate indicators inside the passenger terminal. This testing is undertaken for providing a healthy environment to TIA's employees, third party staff, passengers and visitors. In this regard, measurement of CO₂, relative humidity (RH), air temperature, movement of air, and light intensity is performed.

Particles - PM₁₀ µg/m³
(EU limit - 40 µg/m³; Al limit - 70 µg/m³)
Grimcat e pluhurit - PM₁₀ µg/m³
(Standardi BE - 40 µg/m³; Standardi Shqiptar - 70 µg/m³)



Carbon monoxide - CO µg/m
(EU limit - 10 µg/m³; Al limit - 6 µg/m³)
Monoksidi i karbonit - CO µg/m³
(Standardi BE - 10 µg/m³; Standardi Shqiptar - 6 µg/m³)



*s/w - summer/winter

*s/w - verë/dimër

As with emission levels, the results of micro-climate indicators analysis were found to be in compliance with the respective standards and the occupational health and safety and public health legislation.

As part of TIA's objectives to maintain low emission levels at the Airport, the company introduced a novel idea consisting of the construction of a Kiss-and-Fly Zone for passengers and visitors in the drop-off area in front of the passenger terminal. TIA's customers are obliged to respect the new rules inside the Kiss-and-Fly Zone, improving traffic flow and circulation, and contributing towards the minimisation of gas emissions and improvement in air quality.



Monitorimi Cilësisë së Ajrit

TIA kryen monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit gjatë periudhës së pikut dhe jashtë periudhës së pikut. Objektivi kryesor i monitorimit të cilësisë së ajrit është sigurimi i informacionit rreth përqendrimit të gazeve ndotës dhe ndryshimet e këtyre përqendrimeve tek parametrat kryesor që ndikojnë në mjedis dhe shëndet, duke përfshirë nivelet e dioksidit të azotit (NO₂), ozonit (O₃), monoksid karboni (CO), dioksid sulfuri (SO₂) dhe grimcat e pluhurit PM₁₀ < 10 µm.

Aktivitetet në ose pranë Aeroportit përfshijnë mjaft automjete, veçanërisht ato që përdoren për shërbime transporti në tokë, dhe burime të tjera gazrash dhe grimcash pluhuri që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Kështu që, shumë zona të Aeroportit monitorohen vazhdimisht për shkarkimet në ajër. Rezultatet e monitorimit për 2011-ën janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm për çdo parametër ajri të matur që ndikon në cilësinë e ajrit.

Nivelet e shkarkimeve në ajër të përfuara nga monitorimi janë nën limitet e pranueshme të Shqipërisë (të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave – VKM- Nr. 803 datë 4 dhjetor 2003 "Për normat e cilësisë së ajrit" si dhe ato të BE-së.

Pjesë e programit të monitorimit të cilësisë së ajrit përfshin matjet e treguesve kryesor mikro-klimatik brenda terminalit të pasagjerëve. Ky observim është kryer për t'u ofruar një mjedis të shëndetshëm punonjësve të TIA-s, kontraktorëve, pasagjerëve dhe vizitorëve. Në këtë aspekt, u kryen matjet e CO₂, lagështirës relative, temperaturës së ajrit, lëvizjes së ajrit dhe intensitetit të dritës.

Ashtu si nivelet e shkarkimeve në ajër, rezultatet e analizës së treguesve mikro-klimatik ishin në përputhje me standardet e duhura dhe legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe atë të shëndetit publik.


Si pjesë e objektivave të TIA-s për të mbajtur nivele të ulta të shkarkimeve në ajër në Aeroport, kompania prezantoi një ide të re që konsiston në ndërtimin e një zone Kiss-and-Fly (Përshtëndetudhe-Fluturo) për pasagjerët dhe vizitorët në zonën e lënies së bagazheve në terminalin e pasagjerëve. Klientet e TIA-s janë të detyruar të respektojnë rregulloret e reja brenda zonës Kiss-and-Fly, duke përmirësuar lëvizjen dhe qarkullimin e trafikut dhe duke kontribuar në drejtim të minimizimit të shkarkimeve në ajër si dhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Sulphur dioxide - SO₂ µg/m³

(EU limit - 40 µg/m³; AI limit - 60 µg/m³)

Dioksidi i squfurit - SO₂ µg/m³

(Standardi BE - 40 µg/m³; Standardi Shqiptar - 60 µg/m³)




Nitrogen dioxide - NO₂ µg/m³

(EU limit - 40 µg/m³; AI limit - 50 µg/m³)

Dioksidi i azotit - NO₂ µg/m³

(Standardi BE - 40 µg/m³; Standardi Shqiptar - 50 µg/m³)




Ozone - O₃ µg/m³

(EU limit - 110 µg/m³; AI limit - 120 µg/m³)

Ozoni-O₃ µg/m³

(Standardi BE - 110 µg/m³; Standardi Shqiptar - 120 µg/m³)



*s/w - summer/winter

*s/w - verë/dimër

Water Management

Following careful monitoring and analysis of the Airport processes, TIA proposed and has undertaken preventative measures that aim to protect surface and ground waters and their sources, to achieve water quality objectives and prevent impacts to the environment and ensure regulatory and legal compliance.

Also, third parties are requested to comply with their contractual requirements, environmental guidelines and legal provisions, which are supervised and controlled on a continuous basis. Meanwhile, all members of the TIA community (employees, third parties, etc.) are aware of their responsibility to save water in their working area and in other airport facilities.

The quality of potable water is checked periodically by TIA. The potable water analyses include the checking of physical and bacteriological parameters. In this process, TIA is supported by public health authorities. The results of the analysis are found to comply with health and safety standards.

Waste water monitoring is carried out continuously and aims at compliance with standards and proposals for measures to be undertaken if necessary to prevent water pollution. Samples are taken regularly and analysed by the laboratory of the Institute of Public Health.

Compliance with Albanian and EU standards is provided for through analysis of the following three parameters:

- Biochemical Oxygen Demand (BOD5);
- Chemical Oxygen Demand (COD);
- Suspended Solids (SS).

| | | |
|------|------------|-------------------------------------|
| BOD5 | 5 - 10mg/l | EU standard/Albanian limit, 25mg/l |
| COD | 8 - 14mg/l | EU standard/Albanian limit, 125mg/l |
| SS | 8 - 15mg/l | EU standard/Albanian limit, 60mg/l |

Noise Monitoring

Continuous noise monitoring is carried out by TIA in the vicinity of the Airport, inside and outside the passenger terminal. The aim of the programme is to sample and measure day-time and night-time average noise levels both inside and outside the Airport area. As with previous programmes, the last monitoring enabled comparison of common indicators.

In order to provide an overview of the noise levels at the Airport, measurements were conducted during the peak period (June – July 2011) and the non-peak period (October – November 2011). Monitoring consisted of 24-hour noise measurements conducted during day-time (07.00 – 19.00 hrs.), evening (19.00 – 23.00 hrs.) and night-time (23.00 – 07.00 hrs.). The 2011 measurement's positions do not differ from those of 2010.

The average noise levels were as follows:

- daytime: 67.3 dB(A);
- evening: 65.7 dB(A);
- night-time: 65.3 dB(A).

There was no substantial change in the average noise levels recorded for 2011, in that the results all fall within a normal variation of $\pm 2-3$ percent. The results obtained were found to be within the limits defined in Guideline 8, dated 27 November 2007: "On noise limits in specific environments", which is based on World Health Organisation standards.

At the end of 2011, TIA introduced a new system for permanent noise monitoring. The permanent noise monitoring terminal is designed for long-term outdoor measurements, and consists in two noise poles (or two noise monitoring terminals) installed at the two ends of the runway. The southern noise monitoring terminal is furnished with weather sensors for measuring wind speed, wind direction and rainfall.

Installation of a permanent noise monitoring system is in accordance with the Albanian legislation in force based on EU Directive 2002/49/EC, which concerns assessment and management of environmental noise.



Menaxhimi i Ujërave

Duke ndjekur monitorimin e kujdesshëm dhe analizën e proceseve që kryhen në Aeroport, TIA propozoi dhe ka ndërmarrë masa parandaluese të cilat synojnë të mbrojnë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe burimet e tyre për të arritur objektivat e cilësisë së ujit si dhe të parandalojë ndikimet në mjedis dhe të sigurojë përputhshmëri rregullatore dhe ligjore.

Gjithashtu, palëve të treta u kërkohet të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale, udhëzimet mjedisore dhe dispozitat ligjore, të cilat mbikqyren dhe kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa, të gjithë anëtarët e komunitetit të TIA-s (punonjësit, palët e treta, etj.) janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për të kursyer ujin në mjedisin e tyre të punës dhe në facilitetet e tjera të Aeroportit.

Cilësia e ujit të pijshëm kontrollohet në mënyrë periodike nga TIA. Analizat e ujit të pijshëm përfshijnë kontrollin e parametrave fizik dhe bakteriologjik. Në këtë proces, TIA mbështetet nga autoitetet e shëndetit publik. Analizat rezultuan në përputhje me standardet e shëndetit dhe sigurisë.

Monitorimi i ujërave të ndotura kryhet vazhdimisht dhe synon përputhshmërinë me standardet si dhe propozimet për masat që duhen marrë nëse është e nevojshme për të parandaluar ndotjen e ujit. Mostrat e ujit merren rregullisht dhe analizohen nga laboratorit i Institutit të Shëndetit Publik.

Përputhshmëri me standardet Shqiptare dhe të BE-së jepen në ujërat e ndotura të analizuar për këto tre parametra:

- Kërkesa Biokimike për Oksigjen (KBO5);
- Kërkesa Kimike për Oksigjen (KKO);
- Lëndët Pezull (LP).

| | | |
|------|------------|--|
| KBO5 | 5 - 10mg/l | Standardi BE-së/Standardi Shqiptar 25mg/l |
| KKO | 8 - 14mg/l | Standardi BE-së/Standardi Shqiptar 125mg/l |
| LP | 8 - 15mg/l | Standardi BE-së/Standardi Shqiptar 60mg/l |

Monitorimi i Zhurmave

TIA monitoron nivelet e zhurmave në mënyrë të vazhdueshme në zonën e Aeroportit, pranë tij dhe brenda terminalit të pasagjerëve. Programi ka si qëllim kryerjen e matjeve dhe llogaritjen e nivelit mesatar të zhurmës gjatë ditës, gjatë mbrëmjes dhe gjatë natës brenda dhe jashtë zonës së Aeroportit. Ashtu si edhe në programet e mëparshme, monitorimi në vitin 2011 mundësoi krahasimin e treguesve të njëjtë.

Në mënyrë që të paraqitet një panoramë e niveleve të zhurmës në Aeroport, matjet u kryen gjatë periudhës së pikut (qershor – korrik 2011) dhe në periudhë jo piku (tetor – nëntor 2011). Monitorimi konsistoi në matje 24 orë-she të zhurmave të kryera gjatë ditës (ora 07.00 – 19.00), gjatë mbrëmjes (19.00 – 23.00) dhe gjatë natës (23.00 – 07.00.). Pozicionet e matjeve të 2011 nuk ndryshojnë nga ato të 2010.

Nivelet mesatare të zhurmave ishin si vijon:

- gjatë ditës: 67.3 dB(A);
- gjatë mbrëmjes: 65.7 dB(A);
- gjatë natës: 65.3 dB(A).

Nivelet mesatare të zhurmës të regjistruara për 2011 nuk patën asnjë ndryshim të rëndësishëm, të gjitha rezultatet bien brenda nje luhate normale $\pm 2-3$ përqind rreth rezultateve të vitit të kaluar. Rezultatet e perftuara ishin brenda limiteve të përcaktuara në Udhezimin 8, datë 27 nëntor 2007 "Për limitet e zhurmave në mjedise specifike", i cili bazohet në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Sustainable Constructions

The following construction projects were performed at TIA during 2011:

- construction of a New Storm Water Pipeline to the Terkuza River (inside & outside of the Concession Area);
- construction of a New Perimeter Road West inside the Concession Area.

The construction works were carried out in close cooperation between respective departments of TIA and construction companies. TIA supervised the companies for compliance with construction and environmental health & safety standards and regulations. In this regard, special attention was paid to proper implementation of TIA's Construction Monitoring Programme for Environmental Protection.

Waste Management

TIA's waste management programme is part of the EHSAP (see Page 6). Through close cooperation among the different parties, definition of roles and responsibilities and control over the implementation, compliance with respective regulations and guidelines regarding waste management is provided.

By expanding the programme that promotes TIA's Reuse–Reduce–Recycle concept, the Company has encouraged its customers to participate in the important recycling environmental programme on its premises by helping to increase the amount of material that is recyclable. Being conscious of the importance of raising awareness, campaigns have helped TIA achieve the targets set in this regard.

The target of the waste management programme is to minimize the amount of non-recycled waste produced at the Airport and control the disposal of waste by third parties.

TIA, together with its maintenance contractor and third parties, strictly manages the proper discharge, division at source, minimization and collection, and cooperates with contracted companies operating in compliance with Albanian standards and regulations. These companies manage the transportation and disposal of urban waste, and collection and treatment of recyclable waste, including the collection and treatment of hazardous waste.

Wildlife Habitat Programme

According to TIA's Bird Control Management Plan, which is based upon a Wildlife Habitat Mitigation Study, continuous monitoring and record keeping is provided. The statistical data (including surface and vegetation cover), which serve as baseline information, are collected and analysed. The main bird species present, their numbers, those posing a potential risk to aircraft, large flocks, the location and distribution of monitored birds, etc. are recorded. A guide containing information on bird species at TIA, awareness training and various meetings has helped in provision of a means for accurate bird identification by Airport staff.





Në fund të vitit 2011, TIA prezantoi një sistem të ri për monitorimin e zhurmave në mënyrë të vazhdueshme. Sistemi i monitorimit të vazhdueshëm të niveleve të zhurmës është i projektuar për matje të nivelit të zhurmës në hapësirën e jashtme me një afat kohor të gjatë dhe përbëhet nga dy pajisje monitoruese zhurmash të instaluar në të dy akset e pistës. Pajisja e monitorimit të zhurmës e vendosur në pjesën jugore është e pajisur me sensorë për matjen e kushteve atmosferike si: matjen e shpejtësisë së erës, drejtimin e erës si dhe nivelin e reshjeve të shiut.

Instalimi i sistemit të monitorimit të vazhdueshëm të nivelit të zhurmave është në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi në bazë të Direktives së BE-së 2002/49/EC, e cila lidhet me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore.

Ndërtime Sipas Parimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Projektet e mëposhtme të konstruksionit u kryen në TIA gjatë 2011:

- ndërtimi i linjës së re të shkarkimit të ujërave sipërfaqësorë në Lumin Tërkuza (brenda dhe jashtë Zonës së Koncesionit);
- ndërtimi i Rrugës së Re Perimetrale në pjesën perëndimore brenda Zonës së Koncesionit.

Punimet e ndërtimit u kryen në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet departamenteve përkatëse të TIA-s dhe kompanive të ndërtimit. TIA mbikqyri kompanitë që të jenë në përputhje me standardet e ndërtimit, mjedisore, ato të shëndetit dhe sigurisë si dhe rregulloret. Vëmendje e veçantë iu kushtua në këtë aspekt zbatimit të duhur të Programit të Monitorimit të Ndërtimit të TIA-s për Mbrojtje Mjedisore.

Menaxhimi i Mbetjeve

Programi i menaxhimit të mbetjeve të TIA-s është pjesë e Planit të Veprimit të Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë dhe atij Social. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë mes palëve të ndryshme vendoset përcaktimi i roleve, përgjegjësitë dhe kontrolli për zbatimin, përputhshmërinë me rregulloret dhe udhëzimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Me zgjerimin e programit që promovon konceptin e TIA-s Ripërdor-Redukto-Riciklo, Kompania ka nxitur klientët e saj të marrin pjesë në programin e rëndësishëm të riciklimit mjedisor në mjediset e saj duke ndihmuar në rritjen e sasisë së materialeve të riciklueshme. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e ngritjes së ndërgjegjësisimit, fushatat mjedisore kanë ndihmuar që TIA të arrijë objektivat e përcaktuara në këtë aspekt.

Qëllimi i programit të menaxhimit të mbetjeve ka si synim të minimizojë sasinë e mbetjeve të pariciklueshme të prodhuara në Aeroport dhe të kontrollojë largimin e mbetjeve nga palet e treta.

TIA së bashku me kontraktorin e tij të mirëmbajtjes dhe palët e treta, menaxhojnë në mënyrë strikte shkarkimet e mbetjeve në mënyrë të përshtatshme, ndarjen e tyre në burim, minimizimin dhe grumbullimin si dhe bashkëpunon me kompanitë e kontraktuara që operojnë në përputhje me standardet dhe rregulloret Shqiptare. Këto kompani menaxhojnë transportin dhe largimin e mbetjeve urbane si dhe trajtimin e mbetjeve të riciklueshme duke përfshirë grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.

Programi i Habitatit të Botës së Gjallë

Sipas Planit të Menaxhimit të Kontrollit të Zogjve, i cili bazohet në studimin e Habiteteve të botës së gjallë TIA ka siguruar mbajtjen e rekordeve dhe kryen një proces monitorimi të vazhdueshëm. Të dhënat statistikore, duke përfshirë sipërfaqen dhe mbulimin e bimësisë të cilat shërbejnë si informacion bazë, mblidhen dhe analizohen si edhe janë identifikuar llojet kryesore të zogjve së bashku me numrin e zogjve, llojet që përbëjnë një rrezik të mundshëm për avionin, tufat e mëdha, vendndodhjet, si dhe shpërndarja e tyre bazuar në monitorimet, etj. Një udhëzues që përmban informacion për speciet e zogjve në TIA, trajnime ndërgjegjësimi dhe takime të ndryshme kanë ndihmuar në identifikimin e duhur të zogjve nga punonjësit e Aeroportit.

With regard to follow-up actions in the area of risk assessment and implementation of Risk Mitigation, the following measures are proposed:

- measures to identify locations attractive to birds;
- measures to guarantee safety operations preventing the presence of birds;
- application of appropriate measures to disperse hazardous bird species;
- application of appropriate measures to prevent bird nesting;
- maintenance of green areas in compliance with respective procedures.

TIA's Energy Saving Concept

Aiming towards energy efficiency optimization and energy cost reduction, TIA, in cooperation with HOCHTIEF Airport, has started an Energy Saving Project while developing sustainable energy-saving actions. The project began in April 2011 with a review of the situation of TIA's current energy and heating demand in order to meet future demands, and also sustainability requirements, and to modernize the existing infrastructure and installations.

Some of the energy-saving measures undertaken so far include the following:

- optimization of the air handling unit at the passenger terminal and administration building;
- energy efficient illumination at the passenger terminal;
- improvement in Ground Service Equipment (GSE);
- undertaking of further analyses in order to define the carbon footprint of the Airport.

World Environment Day at TIA

Aiming to meet its social responsibilities, TIA continued in 2011 to promote green initiatives related to the environment and to raise environmental awareness. Considering environmental education as an important issue, the Airport is committed to increasing public awareness and to continuously promoting practical actions on environment issues. Therefore, on the occasion of the World Environment Day, TIA organized a two-day activity.

On 2 June 2011, TIA held on its premises a one-day training for 25 teachers from schools located around the Airport area: from Rinas, Marqinet, Preza, Qereka and Tapiza. The training was performed by professional trainers and was focused on the newly introduced environmental curriculum and the distribution of materials including teachers' books, children's notebooks, etc.

The same day, following the teachers training, Rinas School, in cooperation with TIA, organized an open lesson with fifth-year children in an activity focused on waste recycling management in order to promote the Reuse–Reduce–Recycle concept. In addition, a group of children from Rinas School prepared a letter on the environmental issues in the area around the school, and sent the letter to the recently elected Head of Commune. The schoolchildren's letter focused on the possibilities and contribution of the local government towards a better environment around the school and in the whole community.

On 3 June 2011, with a view to implement practical activities in the area of waste management, children and teachers from Rinas School visited TIA's waste collection site and the recycling trash compactor installed in the maintenance area. Following the visit to the Airport premises and the one to the waste recycling company, the day ended with an excursion to Preza castle.

Such promotion initiatives will help TIA achieve environmental targets not only within but also outside the Airport area.





Në lidhje me veprimet e ndjekura në fushën e Vlerësimit të rrezikut dhe zbatimit të zbutjes së Rrezikut janë propozuar masat e mëposhtme:

- masa për identifikimin e vendeve të cilat tërheqin zogjtë;
- masa për të garantuar operime të sigurta duke parandaluar praninë e zogjve;
- zbatimi i masave të duhura për të shpërndarë speciet e zogjve të rrezikshëm dhe të parandalojë folelizimin e zogjve;
- mirëmbajtja e zonave të gjelbra në përputhje me procedurat përkatëse.

Koncepti i Kursimit të Energjisë në TIA

Duke synuar optimizimin e efikasitetit të energjisë dhe reduktimin e kostos së energjisë, TIA në bashkëpunim me HOCHTIEF Airport, ka filluar një Projekt të Kursimit të Energjisë, duke zhvilluar veprime të kursimit të energjisë së qëndrueshme. Projekti filloi në prill 2011 me një kontroll të situatës së furnizimit të TIA-s me energji dhe me ngrohje si dhe nevoja për të përmbushur kërkesat e së ardhmes, kërkesat në vazhdimësi si dhe për të modernizuar infrastrukturen dhe instalimet ekzistuese.

Disa nga masat e kursimit të energjisë të ndërmarra deri tani përfshijnë si vijon:

- Optimizim i njësive të trajtimit të ajrit në terminalin e pasagjerëve dhe ndërtesën e administratës;
- Ndriçim me energji efikente në terminalin e pasagjerëve;
- Përmirësim në Pajisjen e Shërbimit në Tokë (GSE);
- Ndërmarrja e analizave të mëtejshme për të përcaktuar gjurmën e karbonit të Aeroportit.

Dita Botërore e Mjedisit në TIA

Me synimin për të përmbushur përgjegjësitë sociale, TIA vazhdoi në 2011 të promovojë iniciativat e gjelbra për mjedisin dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor. Duke konsideruar edukimin mjedisor si një çështje të rëndësishme, Aeroporti është i angazhuar të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të promovojë vazhdimisht veprimtari praktike për çështjet e mjedisit. Prandaj, me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit TIA organizoi një aktivitet dy-ditor.


Më 2 qershor 2011, TIA organizoi në mjediset e saj një trajnim njëditor për 25 mësues nga shkollat që ndodhen rreth zonës së Aeroportit, si Rinasit, Marqineti, Preza, Qereka dhe Tapiza. Trajnimi u krye nga trajnues profesionistë dhe u fokusua në kurrikulumin mjedisor të prezantuar së fundmi si dhe në shpërndarjen e materialeve përfshirë këtu, librat e mësuesve, fletoret e nxënësve, etj. Në të njëjtën ditë pas trajnimit të mësuesve, Shkolla e Rinasit, në bashkëpunim me TIA-n, organizoi një orë mësimi të hapur me fëmijë të klasës së pestë në një aktivitet të fokusuar në menaxhimin e riciklimit të mbetjeve në mënyrë që të promovojë konceptin Ripërdor-Redukto-Riciklo. Përveç kësaj, një grup fëmijësh nga Shkolla e Rinasit kishin përgatitur një letër në lidhje me tematikën e çështjeve mjedisore në zonën rreth shkollës. Kjo letër ju dërgua kryetarit të komunës, letra fokusohet në mundësitë dhe kontributin e pushtetit lokal për një ambient më të mirë rreth shkollës dhe në të gjithë komunitetin.

Për më tepër më 3 qershor 2011, duke i dhënë rëndësi aktiviteteve praktike në fushën e menaxhimit të mbetjeve, fëmijët dhe mësuesit nga Shkolla e Rinasit vizituan pikën e grumbullimit të mbetjeve të TIA-s dhe makinerinë teknologjike për grumbullimin dhe kompaktësimin e mbetjeve të riciklueshme, e instaluar në zonën e mirëmbajtjes. Pas vizitës në ambientet e Aeroportit dhe asaj tek kompania e riciklimit të mbetjeve, dita përfundoi me një ekskursion në kështjellën e Prezës.

Këto iniciativa promovimi ndihmojnë TIA-n të arrijë objektivat mjedisore jo vetëm brenda zonës së Aeroportit por edhe jashtë saj.

Health and Safety

Shëndeti dhe Siguria



In compliance with its values and concerns with health and safety standards, TIA has ensured that health and safety issues are being tackled carefully.

TIA oversees the application of health and safety standards and is taking care that all the necessary measures are undertaken to ensure that these standards are met. Aiming to have all employees aware of health and safety issues and standards and fully comply with them, several training programmes, manuals and procedures have been delivered, along with other publications, to TIA employees.

Committed to protecting the health and safety of its employees, TIA has requested the implementation of regulations in place to avoid risks in the area of occupational health and safety. The same is also requested by TIA's contractors with regard to the managing of occupational health and safety issues of employees.

Working conditions, health and safety of TIA employees and contractor staff have been an area of particular importance for the Airport. In this regard, meetings and trainings in safety awareness for TIA staff have been organized along with several site inspections. TIA has purchased a new ambulift vehicle facilitating services for Persons with Reduced Mobility (PRM) and trained First Aid staff in appropriate use of the vehicle and equipment. In accordance with health legislation, periodic medical check-ups are provided for all TIA employees, while for staff exposed to certain equipment and environments, health checks have been more frequent and complex as per legislation obligations.

The number of accidents at TIA during 2011 was zero, maintaining the rate of 0 percent.

Në përputhje me vlerat dhe çështjen e standardeve të shëndetit dhe të sigurisë, TIA ka bërë të mundur që çështjet e shëndetit dhe sigurisë të trajtohen me kujdes.

TIA mbikëqyr zbatimin e standardeve të shëndetit dhe sigurisë dhe kujdeset të marrë gjithë masat e nevojshme që këto standarde të jenë përmbushur. Me qëllim që gjithë punonjësit të jenë në dijeni të çështjeve të shëndetit dhe sigurisë, standardeve dhe përmbushjes plotësisht së tyre, disa programe trajnimi, manuale dhe procedura u janë shpërndarë punonjësve të TIA-s së bashku me publikime të tjera.

